



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

Nr. 547/2 Prot.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E
SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 389/2 Prot.

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

mbi

“BASHKËPUNIMIN DHE NDËRVEPRIMIN NDËRINSTITUCIONAL”

NISUR NGA:

Interesi dhe dëshira e mirë e të dyja institucioneve për të bashkëpunuar në rritjen e kapaciteteve dhe njohurive profesionale të stafit të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në intensifikimin e shkëmbimit të informacionit midis dy institucioneve, si edhe nga fakti që për Kontrollin e Lartë të Shtetit shtimi i cilësisë së punës audituese është thelbësor dhe për Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhënia e asistencës teknike për përmirësimin e funksionimit të institucioneve që përfshihen në fushën e shërbimit civil paraqet një interes të vecantë;

ME SYNIM:

Rritjen dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në fusha me interes të përbashkët;

DUKE RIAFIRMUAR:

Vendosmërinë për respektimin rigoroz të Kushtetutës dhe të legjislacionit tjetër të fushave përkatëse gjatë proceseve respektive të punës së përbashkët të dy institucioneve;

NË MBËSHTETJE TË:

Ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, që përcakton Kontrollin e Lartë të Shtetit, si institucionin më të lartë shtetëror të auditimit të jashtëm në Republikën e Shqipërisë;
Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nenet 11-16 të tij, të cilat e përcaktojnë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, si institucionin e vetëm që mbikëqyr administrimin e shërbimit civil, në institucionet që përfshihen në fushën e veprimit të këtij ligji, Rregullores “Mbi

procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, neni 26, i cili lejon marrjen e ekspertëve të jashtëm për konstatimin ose sqarimin e fakteve që kanë lidhje me objektin e mbikëqyrjes, në rast se kërkohen njohuri të posaçme, si dhe ligjit nr.44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), i cili është autoriteti kompetent për qëllimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit, përfaqësuar nga **Kryetari, z. Bujar Leskaj** që këtu më poshtë do t’i referohemi si palë,

dhe

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (KMSHC), i cili është autoriteti kompetent për qëllimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit, përfaqësuar nga **Komisioneri, znj.Pranvera Strakosha**, që këtu e më poshtë do t’i referohemi si palë,

Bien dakord mbi Marrëveshjen e Bashkëpunimit, si më poshtë;

NENI 1

OBJEKTIVI

- 1.1** Kjo Marrëveshje do të lehtësojë bashkëpunimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve të palëve dhe do të thjeshtojë komunikimin dhe shkëmbimin e të dhënave që lidhen me fushat me interes të përbashkët, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- 1.2** Bashkëpunimi i përmendur në paragrafin 1, do të zbatohet mbi baza të njëjta dhe mbi parimin e reciprocitetit.

NENI 2

KONTRIBUTI I KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT

- 2.1** Kontrolli i Lartë i Shtetit merr përsipër të angazhojë staf për aktivitete të ndryshme që do të organizohen në bashkëpunim me Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të tilla si trajnime, takime konsultative, tryeza të rumbullakta, workshop-e, seminare, etj; aktivitete këto që synojnë rritjen e cilësisë së punës së stafit të KLSH dhe pjesëmarrjen e KMSHC nëpërmjet asistencës teknike për përmirësimin e funksionimit të institucioneve që përfshihen në fushën e veprimit të ligjit për nëpunësin civil dhe që mbikëqyren nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me administrimin e shërbimit civil. Këto aktivitete do të kryhen sipas një plani pune të përcaktuar nga Sekretariati i realizimit të kësaj Marrëveshje dhe të firmosur nga të dy titullarët e institucioneve.
- 2.2** Kontrolli i Lartë i Shtetit merr përsipër të angazhojë staf dhe në bashkëpunim me Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të realizojë aktivitete të përbashkëta për të sjellë mendimin më të avancuar në fushat respektive, mbi bazën dhe të

eksperiencave konkrete, duke promovuar specialistët më të zotë dhe më të suksesshëm të tij.

NENI 3

KONTRIBUTI I KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

- 3.1** Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil merr përsipër që të përcaktojë staf të vetin për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta me KLSH sipas një plani pune të përcaktuar nga Sekretariati i realizimit të kësaj Marrëveshje dhe të firmosur nga të dy titullarët e institucioneve.
- 3.2** Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil merr përsipër që të kontribuojë me ekspertizën e stafit të tij sipas kushteve të planit të punës të përcaktuar nga Sekretariati i realizimit të kësaj Marrëveshje dhe të firmosur nga të dy titullarët e institucioneve, për realizimin e trajnimeve, konsultave të herëpashershme me stafin e KLSH, tryezave të rrumbullakëta, seminareve, work-shop, etj.

NENI 4

KONTRIBUTE TË PËRBASHKËTA

- 4.1** Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit, marrin përsipër të bashkëpunojnë për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta të lartpërmendura, për t'i ofruar njëri-tjetrit shërbime të ekspertizës dhe trajnimit për fushat respektive të bashkëpunimit, në dobi të rritjes së cilësisë së punës së auditimit edhe nëpërmjet mbështetjes së dhënë nga KMSHC.

NENI 5

KOORDINIMI NDËRMJET PALËVE

- 5.1** Palët për zbatimin e kësaj marrëveshje caktojnë nga një person kontakti për secilin institucion. Këta të dy persona do të themelojnë Sekretariatit e realizimit të kësaj Marrëveshje, i cili do të ketë planin e tij vjetor të punës dhe do të raportojë periodikisht pranë titullarëve të të dy institucioneve për aktivitetet e realizuara.

NENI 6

ADMINISTRIMI I INFORMACIONIT

- 6.1** Informacioni i shkëmbyer mes Palëve administrohet sipas rregullave të parashikuara në Ligjin nr .154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Ligjin nr. 8503, datë 30.06.1999, “Për të Drejtën e Informimit për dokumentet zyrtare” dhe Ligjin nr.8517, datë 22.07.1999, “ Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

NENI 7

DISPOZITA TË FUNDIT

- 7.1** Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët dhe do të mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar.
- 7.2** Çdo ndryshim i saj mund të bëhet me marrëveshje nga Palët nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim, duke saktësuar datën e hyrjes në fuqi.
- 7.3** Përveç parashikimit të paragrafit 1 të këtij neni, kjo Marrëveshje mund të përfundojë në çdo kohë nga secila palë, duke njoftuar paraprakisht me shkrim, palën tjetër.
- 7.4** Marrëveshja hartohet në gjuhën shqipe, përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe dy të tjera në Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi u nënshkrua sot, më datë 02/06/2016.

PËR

KONTROLLIN E LARTË TË SHTETIT

KRYETARI

BUJAR LESKAJ

PËR

**KOMISIONERIN PËR MBIKËQYRJEN
E SHËRBIMIT CIVIL**

KOMISIONERI

PRANVERA STRAKOSHA